



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

Nr. ...61... Prot.

Lezhë, më 13.01.2026

URDHËR

Nr. 11 dt 13.01.2026

“Për hapjen e procedurave të konkurrimit për pozicionet vakante drejtor institucioni arsimor publik, në ZVAP –et në juridiksion të DRAP Lezhë”


Në zbatim të Nenit 55 të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të MAS, Nr. 22, datë 13.11.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, kërkesave të Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar,

Urdhëroj

1. Njoftimin e fillimit të procedurave të shpalljes së vëndeve vakante për “Drejtor Institucioni Arsimit Publik”, në institucionet e arsimit parauniversitar publik, përcaktimin e mënyrës, afatet e dorëzimit të dokumentacionit, sipas shpalljes bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin pozicionin vakant “Drejtor Institucioni Arsimit” në institucionet e arsimit parauniversitar publik, të bëhet në faqen zyrtare web të DRAP Lezhë.
3. Ngarkohen për zbatim të këtij urdhëri Sektori i Administrimit të Burimeve Njerezore në DRAP Lezhë, ZVAP në varësi dhe Institucionet arsimore publike të parashikuara tek shpallja bashkëlidhur këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

SHPLLJE PËR VENDE VAKANTE

NË POZICIONIN “ DREJTOR INSTITUCIONI ARSIMOR” NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PUBLIK

Në zbatim të Nenit 55 të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të MAS, Nr. 22, datë 13.11.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, kërkesave të Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, Urdhër i DRAP Lezhë, Nr.11, datë 13.01.2025, “ Për hapjen e procedurave të konkurrimit për pozicionet vakante drejtor i institucionit arsimor publik në ZVAP në varësi”, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë shpall procedurat për 8 vende vakante (faza e parë), për drejtor të institucioneve arsimore publike në ZVAP në varësi, sipas listës më poshtë:

Nr	Drap	Zvap	Bashkia	Emri i institucioni publik arsimor parauniversitar
1	Lezhë	Has	Has	Shkolla 9-Vjeçare "Jakup Istrefi" Nikoliq
2	Lezhë	Has	Has	Gjimnazi “ Skëndërbeu”
3	Lezhë	Kukës	Kukës	Gjimnazi "Havzi Nela" Kukës
4	Lezhë	Kukës	Kukës	Shkolla e Bashkuar Bardhoc
5	Lezhë	Malësia e Madhe	Malësia e Madhe	Shkolla 9-vjeçare “ Abdyl Bajraktari”
6	Lezhë	Shkoder	Shkoder	Shkolla 9-Vjeçare Speciale “ 3 Dhjetori”
7	Lezhë	Tropojë	Tropojë	Shkolla e Mesme e Bashkuar “Tina Kurti” Legbibaj
8	Lezhë	Vau Dejës	Vau Dejës	Shkolla e Bashkuar Hajmel

1. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për pozicionin drejtues institucioni publik arsimor parauniversitar:

- Të zotërojë arsimim si mësues sipas përcaktimeve të nenit 57 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” me vlerësim jo më pak se “Mirë” në kualifikimin e fundit.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi ndaj tij.
- Të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor.

2. Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në institucionin publik arsimor parauniversitar:

Letëshkrimin (sipas modelit në shtojcën nr. 1 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar");

KEZHË

- Kopje e librezës së punës;
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID);
- Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5 të udhëzimit);
- Çertifikatën e drejtuesit të drejtuesit të institucionit arsimor nga Shkolla e Drejtorëve (nenit 55, i ligjit 44/2023 datë 15.6.2023 "Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH", i ndryshuar)
- Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcë nr. 2 të udhëzimit);
- Vërtetim nga institucioni ku punon, që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Deklaratën për verifikimin e vërtetësinë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati sipas shtojcës 8, të udhëzimit.
- Deklaratën e konfliktit të interesit të aplikantit me punonjësit arsimorë të IPAP-së, (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prind të bashkëshortit/es), (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3 të udhëzimit).

4. MËNYRA DHE AFATET E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar ose në rrugë elektronike në adresën e ZVAP që mbulon institucionin arsimor ku është shpallur vendi vakant.

Dokumentacioni dorëzohet brenda datës 23.01.2026 (brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e shpalljes).

5. FAZAT E KONKURRIMIT

Komisioni i shqyrtimit të dokumentacionit mblidhet jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit, për të bërë shqyrtimin paraprak të dokumentacionit.

Komisioni shqyrton dokumentacionin për mangësi brenda 2 (dy) ditëve pune dhe njofton me shkrim ose e-mail kandidatin që ka mangësi në dosje.

Kandidati nga momenti i njoftimit, ka 3 (tri) ditë pune kohë për të dorëzuar dokumentacionin që mungon.

Pas përfundimit të këtij afati, komisioni shpall listën me kandidatët që kanë dokumentacionin e plotë dhe të saktë, bën vlerësimin e dosjeve si dhe realizon intervistën e strukturuar brenda 1 (një) ditë pune.

Komisioni harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës dhe brenda 3 (tri) ditëve pune shpall në këndin e njoftimeve të IPAP-së tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 7, bashkëlidhur Udhëzimit.

Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 (tri) ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda 1 (një) dite pune.

Në rast se nuk konstatohen probleme procedurale, drejtori i ZVAP brenda 2 (dy) ditëve punë nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell në DRAP dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë.

Drejtori i DRAP realizon intervistat brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i marrjes dijeni të dy kandidatëve me më shumë pikë.

6. SHPALLJA E REZULTATEVE DHE AFATET E ANKIMIT

Brenda 3 (tri) ditëve pune, nga realizimi i intervistës me kandidatët, drejtori i DRAP shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP-së.

Kandidati jofitues ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda 3 (tri) ditëve pune në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Kandidati ankimues merr përgjigje nga Ministria e Arsimit dhe Sportit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune pas mbarimit të afatit të ankimit.

DREJTOR

HASAN

